



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Nr. 875/Prot.

Tiranë më, 18/11 2019

**URDHËR**  
Nr. 126, Datë 18/11/19

**Për**  
**Shtyrjen në kohë të aktiviteteve të Muajit të Hapur 2019**

Bazuar në nenin 25, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Programin e Kryetarit nr. 875, datë 31.10.2019 “Muaji i Hapur në KLSH” për vitin 2019 :

**URDHËROJ:**

1. Muaji i Hapur 2019, sipas programit të miratuar nga Kryetari, nr. 875, datë 31.10.2019 është parashikuar të zhvillohet në datat 1 nëntor-5 dhjetor 2019. Në periudhën 18 nëntor -2 dhjetor, aktivitetet e Muajit të Hapur nuk do të zhvillohen për shkak të ngarkesës në punë të audituesve të KLSH-së, të cilët janë duke mbyllur raportet e auditimit që i referohen kësaj periudhe.
2. Mbështetur në pikën 1 të këtij Urdhri, aktivitetet e pazhvilluara të periudhës 18 nëntor -2 dhjetor 2019 do të zhvillohen në periudhën 2-20 dhjetor 2019. Për këto aktivitete do të merrni në një kohë të dytë Axhendën e zhvillimit të tyre.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri të gjitha strukturat e KLSH-së.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
  
**Bujar LESKAJ**